

VENDIM
Nr. 26, datë 31.5.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS PEQIN SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 31.5.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit: ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës Peqin (U. Peqin) me shkresën nr. 1 prot., datë 15.1.2019 dhe shkresës nr. 31 prot., datë 5.4.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe shtimit të kategorisë së largimit të ujërave të ndotura të U. Peqin në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqëruës, rezulton:

a) Shoqëria U. Peqin ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 19 150 banorë dhe largimin e ujërave të ndotura për 7 600 banorë në Bashkinë Peqin si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria U. Peqin:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Peqin	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njësive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Peqin	Qyteti i Peqinit	7600
2	Karinë	Karine	1035
3	Pajovë	Pajove	935
		Lazarej	595
		Bishqem	620
		Garunje	120
		Paulesh	600
		Grykesh	610
		Cacabeze	195
4	Gjocaj	Rrumbullake	460
		Vashaj	1235
		Bardhas	425
5	Përparim	Perparim	345
		Fatishe	495
		Lolaj	285
		Urucaj+Copanaj	185
		Kodras	295

		Caushaj	135
6	Shezë	Sheze	360
		Pekisht	1110
		Trash	835
		Karthneke	360
		Algjinaj	315
TOTALI			19 150 banorë

Shënim: U. Peqin popullsinë e shërbyer për çdo fshat e ka llogaritur në bazë të kontratave * 5 banorë pasi nuk disponon të dhëna të detajuara për popullsinë në çdo fshat. Në 25 fshatra të Bashkisë Peqin, sh.a. U. Peqin nuk e ofron shërbimin e furnizimit me ujë.

- Zona e shërbimit me kanalizime nga shoqëria U. Peqin:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Peqin	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të njërive administrative	Popullsia e shërbyer
1	Peqin	Qyteti i Peqinit	7600
TOTALI			7600 banorë

Shënim: Me rrjet të kanalizimeve të ujërave të ndotura mbulohet vetëm pjesa e qytetit, pasi në fshatra nuk ka rrjet të kanalizimeve dhe operojnë me gropa sepike.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Amarildo Xhyra mban titullin: “Master Shkencor në Inxhinieri Hidroteknike” marrë në tetor 2017, pranë Universitetit Politeknik Tiranë.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e U. Peqin, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë U. Peqin, rekomandon:

- Shoqëria U. Peqin duhet të aplikojë pranë ERRU-së për rishikimin e nivelit tarifar pas riorganizimit të shoqërisë sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 63;

- Shoqëria U. Peqin duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifës volumetrike për kanalizimin e ujërave të ndotura, i cili është shërbim i ri për këtë shoqëri.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e U. Peqin është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a. me NUIS: K78723108J në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës Peqin sh.a., autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
- a) Drejtues ligjor: Nazmi Toli;
 - b) Drejtues teknik: Amarildo Xhyra.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a. është Bashkia Peqin me njësitë administrative si më poshtë:
- I. Për kategorinë A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik:
 - a) Peqin;
 - b) Karinë (pjes.);
 - c) Pajovë (pjes.);
 - d) Gjocaj (pjes.);
 - e) Përparim (pjes.);
 - f) Shezë (pjes.).
 - II. Për kategorinë C - Për largimin e ujërave të ndotura:
 - a) Peqin.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës Peqin sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës Peqin sh.a. për marrjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani